



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2019
Nr.re.:RK 1454/19

VENDIM PËR TËRHEQJE TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI64/19

Parashtrues

Ejup Koci

**Vlerësim i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për
vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit [C.nr. 204/2015] të 27
prillit 2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka -Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ejup Koci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Polac, komuna e Skenderajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [C.nr. 204/2015] të 27 prillit 2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (Dega në Skenderaj).
3. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata tërheqjen e kërkesës së tij.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë..
8. Më 23 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
9. Më 25 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19.

11. Më 25 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta miratojë kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi parashtron kërkesë për herë të tretë në Gjykatë.
13. Në lidhje me kërkesën e parë, më 8 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën KI109/17 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi tejzgjatjen e procedurave, përkatësisht zvarritjen e procedurës për vendosje në lëndën civile [C. nr. 0355/2011], e cila kishte të bënte me shpronësimin e paluajtshmërive për shkak të ndërtimit të rrugës ndërkomunale Skenderaj-Vushtrri. Parashtruesi, në atë rast, pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së. Më 30 maj 2018, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri nr. KI109/17, me të cilin konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (gjegjësisht të drejtën në gjykim të drejtë, brenda një afati kohor të arsyeshëm).
14. Në lidhje me kërkesën e dytë, më 22 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI161/18 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktvendimin [Rev. Nr. 105/2018] të Gjykatës Supreme me pretendimin se nuk i është respektuar e drejta për qasje në gjykatë ngase Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk morën parasysh provat e parashtruara nga ai. Parashtruesi në atë rast, pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 31 [E drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshme], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrotja e Pronës], 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së. Më 23 korrik 2019, Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme pasi që kërkesa nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI64/19

15. Më 7 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër H.F.K. për uzurpim të pronës se tij me rastin e përcaktimit të shenjave të përhershme të kufirit të pronës.
16. Më 17 janar 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë përmes Aktvendimit [C. nr.204/2015] ia ktheu padinë parashtruesit të kërkesës për plotësim.
17. Më 27 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.204/2015] të 27 prillit 2017 ndërpreu procedurën kontestimore të parashtruesit të kërkesës dhe e udhëzoi parashtruesin e kërkesës që të fillojë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë në procedurën gjyqësore jashtë-kontestimore, me arsyetimin se

përveç parashtruesit të kërkesës, bashkëpronarë të pronës së kontestuar janë edhe trashëgimtarë të tjerë.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, të cilën e tërhoqi më vonë.
19. Më 27 prill 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë përmes Aktvendimit [CT.nr.33/2018] i shpalli trashëgimtarë të pronës së kontestuar A. Sh. K., M.Sh.K., dhe E. Sh. K.
20. Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore në Mitrovicë me propozimin për vazhdimin e procedurës gjyqësore të ndërprerë me Aktvendimin [C.nr.2004/2015] e 27 prillit 2017.
21. Më 19 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Mitrovicë e njoftoi parashtruesin e kërkesës se lënda është në procedurë dhe se është evidentuar me numër të ri [C.nr. 256/2018].

Kërkesa për tërheqje të kërkesës nr. KI64/19

22. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë kërkesën për tërheqjen e kërkesës së tij. Në shkresën e tij, ndër të tjera, ai deklaroi:

“[...] e tërheq parashtruesin KI64/19 e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për arsyeje se jam i bindur se në institucionin i cili duhet të jetë maja e drejtësisë nuk ka drejtësi [...].”

Vlerësimi i kërkesës për tërheqje të kërkesës

23. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj, si dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
24. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij, Gjykata së pari do të bëjë shqyrtimin e kërkesës për tërheqje dhe në këtë aspekt, ajo së pari i referohet dispozitave përkatëse ligjore dhe të Rregullores së punës, si në vijim:

*Neni 23
[Tërheqja e palës]*

“Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i’u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuar pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.”

*Rregulli 35
[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]*

“(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë

para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën.”

25. Kësisoj, mbi bazën e dispozitave të mësipërme është paraparë mundësia që parashtruesi i kërkesës ta tërheqë atë, qoftë: (i) para fillimit të seancës dëgjimore, ose (ii) para marrjes së vendimit nga Gjykata, në rastet kur nuk zhvillohet seancë dëgjimore. Por, Gjykata ka diskrecion të plotë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së një kërkesë të tillë, nga rasti në rast.
26. Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, duke iu referuar edhe praktikës së saj gjyqësore, vlerëson se nuk ka ndonjë arsye bindëse për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të kontestuar, përkundër kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij (shih, gjithashtu, rastin nr. KIO4/17, parashtrues Z. K., Vendim për tërheqje të kërkesës, i 28 korrikut 2017, paragrafi 19 dhe rastin nr. KI110/17, parashtrues Sekule Stanković, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 13 qershorit 2018, paragrafi 18).
27. Rrjedhimisht, Gjykata, në pajtim me nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 35 të Rregullores së punës, miraton kërkesën e parashtruesit për tërheqje të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 23 të Ligjit dhe rregullit 35 të Rregullores së punës, më 25 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË MIRATOJË kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi